



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 69

Shtator

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.161, datë 11.4.1994	Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore... 3
Vendim i KM nr.581, datë 25.10.1995	Për rritjen e pensioneve..... 8
Vendim i KM nr.229, datë 1.4.1996	Për rritjen e pensioneve..... 9
Vendim i KM nr.382, datë 20.5.1996	Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”..... 10
Vendim i KM nr.471 datë 15.7.1996	Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm..... 16
Vendim i KM nr.67, datë 30.1.1998	Për rritjen e pensioneve..... 17
Udhëzim i KM nr.2, datë 4.1.1992	Për zbatimin e ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”..... 18
Udhëzim i KM nr.7, datë 29.10.1992	Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 4.1.1992..... 20
Udhëzim i KM nr.2, datë 6.3.1993	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.2, datë 4.1.1992 “Për zbatimin e ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” ndryshuar me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.7, datë 29.10.1992..... 21

VENDIM
Nr.161, datë 11.4.1994

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 78 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Ministrit të Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e "Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.391, datë 3.9.1992 "Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

STATUTI
I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

KREU I
KRIJIMI DHE VENDI

Neni 1

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që më poshtë do të quhet ISSH, është institucion publik shtetëror i pavarur. Veprimtaria e tij rregullohet me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

ISSH-ja është person juridik shqiptar me qendër në Tiranë. Ai operon me zyrat rajonale dhe agjencitë lokale, që veprojnë në gjithë vendin.

KREU II
FONDET THEMELORE, BURIMET E FORMIMIT DHE PËRDORIMI I TYRE

Neni 3

ISSH-ja administron fondin e sigurimeve shoqërore në mënyrë të pavarur. Të ardhurat realizohen dhe shpenzimet kryhen sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4

Fondi i ISSH-së administrohet në pesë degë të veçanta:

- Dega e sigurimit për sëmundje;
- Dega e sigurimit për barrë lindje;

- Dega e sigurimit për pensione;
- Dega e sigurimit për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;
- Dega e sigurimit të papunësisë.

Krijohet llogari e veçantë për mbulimin e shpenzimeve administrative.

Nuk lejohet transferimi i fondeve midis degëve të sigurimit shoqëror.

Transferimet lejohen vetëm në rastet e parashikuara në ligj për pagesën e kontributeve e të shpenzimeve administrative.

Neni 5

ISSH-ja krijon një fond rezervë, të barabartë me shumën e pagesave që nevojiten për të përballuar të paktën 3 muaj shpenzimet për pensione.

KREU III VEPRIMTARIA E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Neni 6

Veprimtaria e Institutit të Sigurimeve Shoqërore përfshin:

a) arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga derdhja e kontributit të ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave dhe subjekteve private, pavarësisht nga forma e organizimit të tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;

b) pagimin e përfitimeve të të siguruarve sipas dispozitave ligjore;

c) investon fondin rezervë, me qëllim që të rritet fitimi i ISSH-së.

Neni 7

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet organeve të tij vartëse në rajon e qytete, kryen veprime për sigurimin e detyrueshëm të punonjësve, si dhe cakton masën e ndihmës a të pensionit në bazë të dokumenteve që paraqesin ndërmarrjet, institucionet, organizatat ose vetë të siguruarit.

Sigurimet për sëmundje, lejen e barrëindjes, ndihmat për lindje fëmije, shpenzimet e varrimit dhe pensionet e invaliditetit të pjesshëm për punonjësit e sektorit shtetëror paguhen nga ndërmarrjet, institucionet, organizatat shoqërore etj., për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, kurse për punonjësit e sektorit privat nga agjencitë e sigurimeve shoqërore.

Ndihmat për lindje fëmije dhe shpenzimet e varrimit për pensionistët paguhen nga organet e sigurimeve shoqërore.

Pensionet e të gjitha llojeve paguhen nga agjencitë bankare për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore, sipas kontratës që lidhet, ku përcaktohet edhe masa e komisionit.

Neni 8

ISSH-ja, për shërbimet që u bëhen personave të siguruar, mban shpenzimet e kryera të barabarta me vlerën e materialit të shpenzuar nga ky institucion.

KREU IV KONTABILITETI DHE BILANCI I ISSH-së

Neni 9

Viti financiar i ISSH-së është vit kalendarik, 1 janar deri më 31 dhjetor.

Neni 10

ISSH-ja mban regjistrat dhe librat në përputhje me ligjin dhe rregulloren financiare.

Neni 11

ISSH-ja përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar, si dhe harton planin financiar të vitit ushtrimor. Ato përfshijnë bilancin, llogaritë e të ardhurave e të shpenzimeve dhe evidencat e tjera përkatëse. Raporti vjetor dhe programi i veprimtarisë së ardhshme financiare miratohen nga këshilli administrativ i ISSH-së dhe i paraqiten çdo vit, nëpërmjet Ministrisë të Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Këshilli administrativ miraton komisionin e kontrollit për revizionimin e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Zyrat rajonale kontrollohen nga sektori i kontroll-revizionit në ISSH, kurse agjencitë nga sektori i kontroll-revizionit të zyrave rajonale; revizioni kryhet në përputhje me rregulloren financiare të ISSH-së.

KREU V DREJTORI DHE ADMINISTRIMI I ISSH-së

Neni 13

Drejtimi dhe administrimi i ISSH-së kryhet nga:

- a) këshilli administrativ;
- b) drejtori i përgjithshëm.

Këshilli administrativ është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga 12 anëtarë, të caktuar: 6 nga Këshilli i Ministrave, të cilët do të jenë përfaqësues të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të Ministrisë së Drejtësisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës së Kursimeve dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore; 3 anëtarë nga organizatat e punëdhënësve (në kushtet e mungesës së organizatës së punëdhënësve, 2 anëtarë nga punëdhënësit më të mëdhenj dhe një nga punëdhënësit privatë); 3 anëtarë të sindikatave të mëdha nga numri i anëtarëve të tyre. Përfaqësuesit e punëdhënësve caktohen për periudhën e tranzicionit, deri në formimin e organizatave të punëdhënësve, nga drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke vendosur drejtorët e ndërmarrjeve të mëdha. Emërimi është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Neni 14

Këshilli administrativ zgjedh me votim të fshehtë kryetarin dhe 2 nënkryetarët, të cilët drejtojnë veprimtarinë e këshillit.

Kryetari zgjidhet nga 6 përfaqësuesit e ministrive, kurse 2 zëvendëskryetarët një nga sindikatat dhe një nga punëdhënësit.

Neni 15

Këshilli administrativ mblidhet jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 16

Mbledhja e këshillit administrativ thirret nga kryetari, nga dy nënkryetarët e tij dhe nga drejtori i përgjithshëm i ISSH-së. Ky i fundit ka të drejtë të mbledhë këshillin administrativ kur interesat e ISSH-së kërkojnë vendime të shpejta, që nuk janë në kompetencë të tij.

Neni 17

Mbledhja e këshillit administrativ njoftohet me shkrim të paktën 10 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës. Kur mbledhja e këshillit administrativ thirret nga drejtori i përgjithshëm i ISSH-së, mund të mos zbatohen kriteret e mësipërme.

Neni 18

Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm dy të tretat e anëtarëve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të punëdhënësve dhe të sindikatave si anëtarë të këshillit administrativ. Vendimet merren me shumicë votash.

Nëse shumica nuk arrihet, mbledhja shtyhet për ditën tjetër, duke bërë edhe njëherë njoftimin e pjesëmarrësve. Për mbledhjen e përsëritur do të jetë e nevojshme gjysma e anëtarëve, duke përfshirë një përfaqësues nga punëdhënësit dhe një nga sindikata. Megjithatë, vendimet merren vetëm me dy të tretat e votave.

Neni 19

Për mbledhjet e këshillit administrativ mbahet procesverbal. Kryetari autorizon një person të përhershëm për mbajtjen e tij.

Vendimet e këshillit administrativ nënshkruhen nga kryetari ose një nga nënkryetarët dhe depozitohen në drejtorinë e ISSH-së.

Neni 20

Vendimet e këshillit merren me shumicë absolute votash.

Anëtari i këshillit administrativ ka të drejtën e një vote.

Në rastet kur votat barazohen, vendos vota e kryetarit të këshillit administrativ.

Neni 21

Kompetencat e këshillit administrativ:

- a) Zgjedh drejtorin e përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- b) Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore.
- c) Vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me investimet e fondeve.
- ç) I propozon Ministrin të Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale për ndryshimet në statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe në ligjin për sigurimet shoqërore.
- d) Vendos për lidhjen e marrëveshjeve e të kontratave të rëndësishme.

dh) Miraton komisionin e kontrollit për kontrollin e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

e) Miraton rregulloret, të propozuara nga drejtori i përgjithshëm, që kanë të bëjnë me çështjet financiare.

Neni 22

Anëtarët e këshillit administrativ hiqen nga detyra kur:

- a) dënohen për vepra penale;
- b) japin dorëheqjen;
- c) marrin pjesë ose ndihmojnë në korrupsion;
- ç) janë të paafte për kryerjen e detyrës.

Neni 23

Anëtarët e këshillit administrativ të ISSH-së marrin një shpërblim për pjesëmarrje, masa e të cilit caktohet nga vetë këshilli administrativ.

Neni 24

Drejtori i përgjithshëm i ISSH-së zgjidhet nga këshilli administrativ i ISSH-së.

Ai përfaqëson ISSH-në dhe drejton veprimtarinë e tij.

Përgjigjet për administrimin dhe raporton çdo vit për veprimtarinë e ISSH-së në këshillin administrativ.

Emëron trupin drejtues si organ këshillues i drejtorit.

Neni 25

Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm:

a) Miraton rregulloret e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për organizimin, administrimin dhe procedurat administrative, kur është ngarkuar nga ligji.

b) Përcakton rregullat e brendshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

c) Përcakton dhe miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

ç) Emëron punonjësit e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe drejtorët e drejtorive në rrethe, si dhe përcakton pagat e tyre.

d) Vendos për të gjitha çështjet e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda kufijve të planit financiar të tij.

dh) Vendos për të gjitha çështjet për administrimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe raporton para këshillit administrativ për punën e tij.

e) Propozon në këshillin administrativ buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, planin financiar për 3 vjet dhe rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me kontribucionet dhe problemet financiare.

Neni 26

Në ISSH krijohet trupi drejtues, i përbërë nga zëvendës drejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive.

Trupi drejtues është organ këshillimor i drejtorit.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 27

ISSH-ja ka të drejtë të lëshojë udhëzime, urdhëresa dhe akte të tjera administrative, në mbështetje të akteve ligjore dhe kompetencave që janë dhënë.

Neni 28

ISSH-ja ka të drejtë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje a të kryejë veprimtari të përbashkëta me organizatat joqeveritare ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore.

Neni 29

ISSH-ja ka të drejtën e depozitimit, të përdorimit dhe investimit të mjeteve të tij financiare në bazë të ligjit, rregullores financiare dhe vendimeve të këshillit administrativ.

Neni 30

Nga veprimtaria e ISSH-së caktohet një fond në lekë e në valutë që përdoret për pagesat e kuotacionit të anëtarësisë në ISSA për seminare, kurse e specializime brenda e jashtë vendit, si dhe për pajisje për pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh të huaj, madhësia e të cilave caktohet nga këshilli administrativ.

Neni 31

ISSH-ja ka stemën dhe vulën e tij me shenjat e stemës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 32

Për problemet që nuk janë të përcaktuara në këtë statut, rregullimi do të bëhet me vendim të këshillit administrativ, brenda kompetencave që lejojnë dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 33

Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Këshilli i Ministrave dhe i shtrin efektet që nga data e krijimit të ISSH-së.

VENDIM

Nr.581, datë 25.10.1995

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshohen si vijon:

Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, për vjetërsi shërbimi, për merita të veçanta, pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare me masë pensioni mujor:

- deri në 2420 lekë, rriten 12 për qind;
- nga 2421 lekë deri në 2510 lekë, bëhen 2710 lekë;
- nga 2511 lekë deri në 4074 lekë, rriten 8 për qind;
- nga 4075 lekë deri në 4400 lekë, bëhen 4400 lekë.

Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, me datë fillimi nga 1 tetori 1995 e në vazhdim, nuk mund të caktohet më pak se 2710 lekë në muaj. Pensioni maksimal mbetet 4400 lekë në muaj. Kufiri maksimal për pensione shtetërore të posaçme mbetet 8800 lekë në muaj.

2. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", rriten në masën 10 për qind.

3. Shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit për invalidët e luftës, e përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", rritet në masën 8 për qind.

4. Pensionet e caktuara në bazë të nenit 40 të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 nuk do të kenë kufi në lidhje me pagesën, kur përfituesi punon në sektorin privat, kurse për ata që punojnë në sektorin shtetëror, të ardhurat (paga + pension) nuk duhet të kalojnë pagën e sotme analoge me atë të funksionit që ata kanë pasur kur kanë përfituar pension.

5. Nuk përfitojnë rritje pensioni personat, pensioni i të cilëve është caktuar sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe personat që sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit të përcaktuar nga paragrafi i parë, pika II, e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 23.1.1995.

6. Efektet financiare mujore nga rritja e pensioneve janë 90 milionë lekë. Për këtë, në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, deri më 31.12.1995, shtohen 270 milionë lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995.

7. Për të përballuar punën për rritjen e pensioneve, shpenzimet për shtypshkrime dhe komisionet e bankave, në planin e shpenzimeve administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1995, shtohen 10 milionë lekë, nga të cilat, fond page për shpërblimin e punonjësve dhe punonjësve provizorë, 4 milionë lekë. Shuma prej 10 milionë lekësh përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995.

8. Për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.10.1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM
Nr.229, datë 1.4.1996

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore" dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshohen si vijon:

a) Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi me masë pensioni mujor:

- deri në 2600 lekë, rriten 25 për qind;

- nga 2601 lekë deri në 2826 lekë, bëhen 3250 lekë;
- mbi 2827 lekë rriten 15 për qind.

b) Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 20 për qind.

c) Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", rriten në masën 20 për qind.

ç) Rritet në masën 15 për qind shtesa mujore e përfitur nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar".

2. Përfitojnë rritje pensioni në masën 25 për qind personat, të cilët pensioni u është caktuar sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", si dhe personat që pensioni u është caktuar sipas nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

3. Rritjen në masat e caktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.12.1996, duke përfshirë edhe këtë datë.

- Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit i llogaritur sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me datë fillimi 1.4.1996, nuk mund të caktohet më pak se 3250 lekë në muaj. Masa e pensionit maksimal mbetet 5420 lekë në muaj.

- Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, i llogaritur sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 dhe nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me datë fillimi nga 1.4.1996, nuk mund të caktohen më pak se 875 lekë në muaj.

4. Efektet financiare për vitin 1996 nga rritja e pensioneve janë 1 680 milionë lekë dhe përballohen:

- nga fondet e programuara në planin e vitit 1996 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, 1 460 milionë lekë;

- nga fondet rezervë të Këshillit të Ministrave, 220 milionë lekë.

5. Për përballimin e vëllimit të punës për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 6 milionë lekë fond page, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse, ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga 1.4.1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

VENDIM

Nr.382, datë 20.5.1996

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 "PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT"

Në bazë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në zbatim të pikës 5 të nenit 1 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", njihen vite shërbimi për përfitime sipas këtij ligji vitet e punës, të kryera në funksionet që burojnë nga

Kushtetuta, ose në detyrat e administratës publike, të përcaktuara në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

II. Në zbatim të pikës 7 të nenit 1 të ligjit të mësipërm, me termin "pagë referuese" do të kuptohet paga bruto e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion a detyrë në momentin e lindjes së të drejtës për përfitime shtetërore suplementare.

1. Paga bruto përbëhet nga:

- a) paga bazë e caktuar sipas tabelës së pagave;
- b) shtesa për funksion;
- c) shtesa për vjetërsi në punë; dhe
- d) shtesa për vështirësi në punë.

2. Drejtoria e Pagave pranë Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë përcakton pagën referuese të vendit të punës, kur në momentin e lindjes së të drejtës për përfitime shtetërore suplementare nuk ekziston funksioni a detyra që ka pasur personi, pra nuk ka pagë të miratuar.

III. Në zbatim të pikës 8, shkronja "b" dhe të pikës 9, shkronjat "b", "c" dhe "d", të nenit 1 të ligjit të mësipërm, personat e barazuar me personat që janë në funksione dhe detyra përkatëse, përcaktohen në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

IV. Në zbatim të nenit 4 të ligjit të mësipërm, krijohet fondi i përfitimeve shtetërore suplementare, i cili financohet:

- a) nga Buxheti i Shtetit;
- b) nga kontributi që derdhin personat e punësuar.

Buxheti i Shtetit përcakton çdo vit pjesën që do të financojë në këtë fond. Kjo pjesë do të jetë si diferencë ndërmjet përfitimeve shtetërore suplementare që jepen sipas këtij ligji dhe kontributit që derdhin personat e punësuar.

V. Në zbatim të nenit 6 të ligjit të mësipërm, punëdhënësi është i detyruar:

a) të mbajë nga paga bruto e të punësuarve kontributin e përcaktuar për këta persona në nenin 5 të këtij ligji; dhe

b) ta derdhë atë në llogarinë e fondit të përfitimeve shtetërore suplementare.

1. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe derdhjen e tyre.

2. Punëdhënësi detyrohet të paraqesë, brenda datës 30 të muajit pasardhës:

- a) listën e personave që përfitojnë nga ky ligj, funksionin a detyrën e tyre;
- b) pagën bruto;
- c) shumën e kontributeve të ndaluara, të rakorduara këto me shumën e derdhur në fondin e përfitimeve shtetërore suplementare.

VI. Në zbatim të nenit 7 të ligjit të mësipërm, shpërblimi do të jepet i menjëhershëm pas largimit nga funksioni a detyra.

1. Pas këtij shpërblimi, do të vazhdojnë të marrin pagesën kalimtare:

a) në masën 50% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i katërt, personat e paragrafit të parë të nenit 7;

b) në masën 50% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i tretë, personat e paragrafit të dytë të nenit 7;

c) në masën 40% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i tretë, personat e paragrafit të tretë të nenit 7.

Pagesa e mësipërme do të vazhdojë të jepet për një periudhë kohe jo më të gjatë se afatet e përcaktuara përkatësisht në nenin 7 të këtij ligji.

2.a) Personi nuk merr kompensimin mbi pagë, kur ai punësohet dhe paga e re është më e lartë se paga referuese.

b) Personi do të marrë kompensimin mbi pagë, deri në afate të përcaktuara në këtë nen, kur ai punësohet dhe paga e re është më e ulët se paga referuese. Ky kompensim nuk do të jetë më i lartë se 50% e pagës referuese, të përcaktuar në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 7 të ligjit dhe 40% e saj e përcaktuar në paragrafin e tretë.

3. Pagesat e shpërblimit të menjëhershëm bëhen nga punëdhënësi i fundit.

Për pagimin e shpërblimit të menjëhershëm, punëdhënësi i fundit kërkon nga Ministria e Financave mbulimin e efekteve financiare nga Buxheti i Shtetit.

4. Për pagesën kalimtare, i interesuari do të paraqesë kërkesën pranë organit të sigurimeve shoqërore, bashkëlidhur së cilës do të ketë dhe këto dokumente:

a) vërtetim nga qendra e punës për largimin nga funksioni a detyra, si dhe vitet e shërbimit në këto funksione dhe detyra;

b) pagën referuese;

c) deklaratë nëse është i punësuar dhe pagën që merr, ose deklaratë që nuk është i punësuar. Kjo deklaratë do të jetë e përmuajshme.

5. Pagesa kalimtare caktohet nga organi i sigurimeve shoqërore dhe bëhet:

a) për personat, të cilët nuk janë të punësuar pranë organit financiar të përcaktuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

b) për personat e punësuar pranë qendrës së punës.

Për personat e pikës "b", pagesat rimburohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet fondit të përfitimeve shtetërore suplementare.

VII. Në zbatim të neneve 9, 11, 13 dhe 14 të këtij ligji, masa e pensionit llogaritet dhe caktohet nga organi i sigurimeve shoqërore.

VIII. Në zbatim të nenit 21 të këtij ligji, për të përfituar pensione shtetërore suplementare, i interesuari do të paraqesë pranë organit të sigurimeve shoqërore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për pension;

b) vërtetim nga qendra e punës për funksionet a detyrat e kryera, për të cilat i lind e drejta për pension, vitet e shërbimit për funksionin a detyrën;

c) vërtetimin e pagës për funksionin a detyrën;

d) procesverbalin nga qendra e punës, i cili është mbajtur për aksidentin në shërbim;

e) vendimin e komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë, se është deklaruar invalid i përhershëm nga aksidenti në shërbim;

f) certifikatën e gjendjes familjare;

g) certifikatën e vdekjes;

gj) dëshmi penaliteti.

IX. Në zbatim të nenit 24 të këtij ligji, ngrihet një komision i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili shqyrton dëshminë e penalitetit dhe vendos nëse personi ka të drejtë për të përfituar pension shtetëror suplementar.

X. Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore të krijohet sektori i sigurimit suplementar për administrimin e kësaj skeme.

1. Për kryerjen e pagesave të përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj, Institutit të Sigurimeve Shoqërore në planin e shpenzimeve të vitit 1996, i shtohen 14,2 milionë lekë, që përballohen nga fondi buxhetor i parashikuar për punët publike.

Për kryerjen e shpërblimeve të menjëhershme, që rrjedhin nga ky ligj, Ministrisë së Financave i shtohen 18.5 milionë lekë, të cilat përballohen nga fondi buxhetor i parashikuar për punët publike.

2. Shpenzimet administrative për funksionimin e kësaj skeme përballohen nga Buxheti i Shtetit. Për vitin 1996, në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore shtohen 5 milionë lekë.

XI. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e udhëzimeve, rregullores dhe dokumentacionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerrin një udhëzim të përbashkët për mbledhjen e kontributeve dhe rakordimin e tyre me derdhjen e bërë në fondin e përfitimeve shtetërore suplementare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 1 prilli 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

LISTA PËR FUNKSIONET DHE DETYRAT TË CILAT MERREN PËR BAZË PËR PËRFITIME
SIPAS LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHTETËRORE
SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË
PUNONJËSVE TË SHTETIT”

Neni 1 pika 5 e ligjit

Njihen vite shërbimi për efekt të këtij ligji puna e kryer nga 1.4.1991 e në vazhdim në funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

Për grupin e parë, germa “a”, pika 8, e nenit 1 të këtij ligji:

- Kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor;
- Kryetari i Këshillit të Ministrave;
- Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
- Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetari i Gjykatës së Kasacionit;
- Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;
- Prokurori i Përgjithshëm.

Personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave janë:

- Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave;
- Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës;
- Kryetari i Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Për grupin e parë, germa “b” e pikës 8 të nenit 1 të këtij ligji:

- Deputetët e Kuvendit Popullor;
- Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- Anëtarët e Gjykatës së Kasacionit.

Për grupin e dytë, germa “a” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji:

- Sekretarët e Shtetit;
- Zëvendësministrat;
- Zëvendësprokurorët e Përgjithshëm dhe personat e tjerë të barazuar me ta, si më poshtë:
- Sekretari i Përgjithshëm i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;
- Kryetari i Akademisë së Shkencave;
- Kryetari i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
- Drejtori i Përgjithshëm i RTV-së;
- Drejtori i ATSH-së;
- Zëvendëskryetar i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
- Drejtor i Departamentit pranë Kryeministrit;
- Këshilltar i Kryeministrit;
- Shef i Kabinetit të Kryeministrit;
- Zëdhënës i Kryeministrit;
- Zëvendëskryetarët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;
- Kryetari i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtor i Përgjithshëm i Rezervave Shtetërore;
- Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- Drejtor i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve;

- Këshilltar i Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor;
- Zëdhënës i Kuvendit Popullor;
- Shef i Kabinetit të Kuvendit Popullor;
- Drejtor i Përgjithshëm i Doganave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Financiare;
- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Tatimore;
- Guvernator i Bankës së Shqipërisë;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Kursimit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Tregtare Agrare;
- Prokuror i Gjykatës së Kasacionit;
- Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil;
- Shef i Kabinetit të Presidentit;
- Këshilltar i Presidentit;
- Zëdhënës i Presidentit;
- Prefekti;
- Kryetari i Këshillit të rrethit;
- Kryetari i bashkisë.

Për grupin e dytë, germa “b” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji:

- Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave;
- Sekretar shkencor në Akademinë e Shkencave;
- President i Komitetit Olimpik Shqiptar;
- Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
- Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
- Kryetar i Agjencisë së Privatizimit dhe Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;
- Këshilltar i Zëvendëskryeministrit;
- Shef i Protokollit dhe Ceremonisë në Presidencë;
- Shef i Zyrës së Pritjes së Popullit në Presidencë;
- Kryeinspektor në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
- Drejtor i Përgjithshëm në Ministri;
- Zëvendësdrejtor i përgjithshëm në RTV;
- Drejtor i Radios së Jashtme;
- Drejtor i Radios së Brendshme;
- Drejtor i Televizionit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;
- Kryetar i Qendrës për Nxitjen e Investimeve të Huaja;
- Kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
- Kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimeve;
- Zëvendëskryetar i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Njësisë së Implementimit të Projektit Mobil;
- Shef i Shërbimit të Inspektoratit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave;
- Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Aviacionit Civil;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Ministrive dhe Institucioneve Qendrore;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtor i Ligjshmërisë në Gjykatën e Kasacionit;
- Drejtor i Përgjithshëm i ish-të Përndjekurve Politikë;
- Drejtor i Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit;

- Drejtor i Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë;
- Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
- Përgjegjës i Sektorit në Presidencë;
- Sekretar i Presidentit;
- Kryetar i Komisionit Shtetëror Trepalësh për dhënien e statusit të ish-të përndjekurve politikë;
- Drejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik;
- Kryekëshilltar në Kryesinë e Kuvendit Popullor;
- Këshilltar i Komisionit në Kuvendin Popullor;
- Zëvendës drejtor i ATSH-së;
- Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
- Zëvendëskryetar i Qendrës Shqiptare të Nxitjes së Investimeve të Huaja;
- Zëvendëskryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
- Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës së Tiranës;
- Zëvendës drejtor i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- Zëvendës drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
- Zëvendëspresidentit i Komitetit Olimpik;
- Këshilltar;
- Drejtor drejtorie për probleme të veçanta në Këshillin e Ministrave;
- Ndihmës i Kryetarit të Këshillit të Ministrave;
- Sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar;
- President i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekut;
- Zëdhënës i Gjykatës së Kasacionit;
- Shef Kabineti të Ministrit;
- Sekretar i Kryetarit të Kuvendit Popullor;
- Sekretar i Kryeministrit;
- Kryetar i Gjykatës së Rrethit Tiranë;
- Drejtor drejtorie (Prokuror) në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Prokuror, hetues, oficer i Policisë Gjyqësore në prokurorinë e Përgjithshme;
- Prokuror në Prokurorinë e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
- Zëvendësprokuror në prokurorinë e rrethit;
- Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
- Kryetar në gjykatat e rretheve;
- Prokuror rrethi;
- Zëvendësprokuror rrethi;
- Zëvendëskryetar në gjykatat e rretheve.

Për grupin e dytë, germa “c” e nenit 9 të këtij ligji:

- Drejtor drejtorie në Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
- Zëvendës drejtor në ministri, institucione dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
- Ambasador i Republikës së Shqipërisë;
- Shef sektori në Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
- Konsull në konsullatat e Republikës së Shqipërisë;
- Kryetar dege në ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit.

Për grupin e dytë, germa “d” e nenit 9 të këtij ligji:

- Specialist në ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
- Gjyqtar në gjykatat e rretheve;
- Prokuror;
- Hetues, oficer i Policisë Gjyqësore.

Shënim. Periudha që punonjësit ushtarakë përfitojnë nga ligji nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", përjashtohet.

VENDIM
Nr.471, datë 15.7.1996

PËR KOMPENSIMIN NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË BUKËS, VAJGURIT DHE GAZIT TË LËNGSHËM

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Për efekt të ndryshimit të çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm, t'u jepet kompensim:

1. Në masën 250 lekë në muaj:

a) Të punësuarve në sektorin shtetëror e privat, në shoqëritë tregtare, bankat, INSIG, ISSH, ISKSH, organizatat politike e shoqërore dhe në shoqatat.

b) Personave që trajtohen me pagesë nga ARN-ja.

c) Ushtarakëve që kanë dalë në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura.

2. Në masën 150 lekë në muaj:

a) Personave që marrin pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996 "Për sigurimet shoqërore", ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", kur janë me banim të përhershëm në qytet, si edhe personave që marrin pension nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të atyre që sipas nenit 96 të këtij ligji nuk plotësojnë kushtet për të përfituar masë pensioni shtetëror.

b) Personave që përfitojnë pagesë paaftësie.

3. Niveli bazë i pagesës së papunësisë dhe niveli maksimal i ndihmës ekonomike të plotë që përfiton familja rritet 12%.

II. Nuk përfitojnë kompensim mujor:

1. Punonjësit e administratës së lartë shtetërore, shpërblimi i të cilëve bëhet me pagë mujore të fiksuar.

2. Pensionistët, që kanë përfituar pension sipas ligjit nr.4976, datë 20.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore" dhe ata që kanë përfituar pension sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe sipas nenit 96 të këtij ligji, marrin masë pensioni fshati, kur banojnë në fshat dhe në territorin e ish-ndërmarrjeve bujqësore.

3. Të vetëpunësuarit në sektorin privat, nga koha e marrjes së lejes së ushtrimit të profesionit.

4. Punonjësit që dërgohen jashtë shtetit për studime, specializime pasuniversitare ose për të ndjekur kurse mbi tre muaj.

III. Mënyra e llogaritjes dhe e pagesës së kompensimeve:

1. Familjet bujqësore me të ardhura të pamjaftueshme, kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm do ta përfitojnë pranë zyrave të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në komuna, nëse niveli i të ardhurave të tyre përfshihet në kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike.

2. Kompensimet paguhet një herë në muaj në fillim të muajit për muajin korrent dhe regjistrohen në një kolonë të veçantë të listëpagesës.

3. Të ardhurat personale nga kompensimet nuk taten.

4. Në ndërmarrjet shtetërore, institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore, ky kompensim nuk përfshihet në pagën mesatare për efekte të kontrollit.

IV. Fondet për kompensimin në zbatim të këtij vendimi përballen:

a) Nga Buxheti i Shtetit për punonjësit e institucioneve buxhetore, për personat që marrin pension, personat që përfitojnë pension, pagesë papunësie, pagesë paafësie, ushtarakët e dalë në lirim nga reforma, personat që trajtohen me pagë nga ARN-ja, si dhe për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.

b) Nga vetë subjektet për të punësuarit në shoqëritë tregtare, bankat, INSIG, ISKSH, ISSH, organizatat shoqërore dhe shoqatat.

V. Organizatat politike sipas ligjit të partive u jepet financim shtesë.

VI. Efekti financiar në Buxhetin e Shtetit do të përballohet nga fondi i parashikuar në buxhet për vitin 1996 në zërin "Kontingjencë" prej 400 milionë lekësh, si dhe nga pjesa e subvencionit të diferencës së çmimit të grurit të papërdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, sipas urdhrimit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Ngarkohet Ministria e Financave për të bërë detajimin dhe shpërndarjen e këtij fondi sipas drejtimeve të përdorimit në zbatim të këtij vendimi.

VII. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore hartojnë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më 16 korrik 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

VENDIM

Nr.67, datë 30.1.1998

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996 dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas nenit 96, paragrafi i parafundit i ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshohet si vijon:

Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi me masë pensioni mujor:

- deri në 3250 lekë, rriten 23 për qind;
- nga 3250 lekë deri në 3335 lekë, bëhen 4000 lekë;
- nga 3336 lekë deri 3970 lekë, rriten 20 për qind;
- nga 3971 lekë deri 4070, bëhen 4765 lekë;
- mbi 4071 lekë, rriten 17 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 23 për qind.

Pensionet shtetërore të posaçme rriten në masën 17 për qind.

Shtesa mujore e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.326, datë 21.6.1993 "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", rritet në masën 17 për qind.

Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.1.1998, duke përfshirë edhe këtë datë.

Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, me datë fillimi nga 1.2.1998 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 3997 lekë në muaj.

II. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut", rriten në masën 20 për qind.

III. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", rriten në masën 20 për qind.

Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit që caktohen sipas paragrafit të parafundit të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, me datë fillimi nga 1.2.1998 e në vazhdim nuk mund të llogariten më pak se 1050 lekë në muaj.

IV. Efektet financiare nga rritja e pensioneve janë 2658 milionë lekë dhe do të përballohen nga fondet e programuara në Buxhetin e Shtetit në vitin 1998.

V. Për përballimin e volumit të punës për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 4.5 milionë lekë fond page, të cilat përballohen nga fondet për shpenzime administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 1998.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse ngarkohen ISSH-ja dhe Banka e Kursimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga 1.2.1998.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

UDHËZIM
Nr.2, datë 4.1.1992

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7514, DATË 30.9.1991 "PËR PAFAJËSINË, AMNISTINË DHE REHABILITIMIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË"

Për zbatimin e ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Personat që, në bazë të neneve 1 dhe 5 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991, janë të pafajshëm, për efekt të përfitimit nga sigurimet shoqërore, u njihet vjetërsi pune, në marrëdhënie me shtetin, e kategorisë së parë, koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë dhe me internim, kur internimi është dhënë si dënim penal plotësues.

Personave të pafajshëm, që para se të ndiqeshin penalisht kanë qenë në marrëdhënie pune, për të cilët jepet pension për vjetërsi shërbimi, koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë dhe me internim si dënim penal plotësues u njihet e vlefshme për pension për vjetërsi shërbimi.

2. Personi i pafajshëm, për kohën që ka punuar gjatë vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë, ka të drejtë që për efekt pensioni të zgjedhë pagën e punonjësit në gjendje të lirë, që ka punuar në kushte të njëjta pune me atë që ka kryer personi gjatë vuajtjes së dënimit. Dokumenti i pagës për periudhën e punuar gjatë vuajtjes së dënimit jepet nga administrata e repartit ku është vuajtur dënim. Në këto raste paga nxirret nga listëpagesat dhe llogaritet çdo muaj në bazë të kategorisë personale ose të punës së të dënuarit dhe përqindjes së realizimit të normës. Kur përcaktimi i pagës nuk mund të bëhet për shkaqe të ndryshme, personit të pafajshëm i jepet pensioni mesatar, që do të konsiderohet mesatarja ndërmjet kufirit minimal e maksimal të pensionit që parashikon ligji. Për shembull, mesatarja e pensionit të plotë të pleqërisë do të merret në masën 855 lekë në muaj, duke e

llogaritur në këtë mënyrë: $(660+1050):2$. Kur kërkohet që paga mesatare të merret si nga koha e vuajtjes së dënimit, ashtu dhe nga koha para ose pas vuajtjes së dënimit, paga mesatare do të llogaritet mbi të ardhurat e realizuara gjatë tre vjetëve me radhë.

3. Anëtarët e familjes së personave që përmenden në shkronjën “e” të nenit 5 të ligjit përfitojnë pension familjar. Përllogaritja e pensionit do të bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij udhëzimi. Kur mbajtësi i familjes nuk ka pasur vjetërsi në punë, sipas ligjit, do t’i jepet pension familjar mesatar. Ky pension do të përllogaritet si mesatare ndërmjet minimumit dhe maksimumit të pensionit familjar dhe sipas numrit të pjesëtarëve të familjes në ngarkim.

4. Të drejtat e mësipërme në fushën e sigurimeve shoqërore i përfiton edhe personi i dëbuar ose i internuar për shkaqe politike, në bazë të dokumentit që do të paraqesë për shkakun dhe kohën e vuajtjes së këtyre dënimeve.

5. Për të përfituar të drejtat që parashikon ligji “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” në fushën e sigurimeve shoqërore, të interesuarit e pafajshëm duhet të paraqesin në organet e sigurimeve shoqërore të rrethit dokumentet përkatëse, ndër të cilat edhe vërtetimin për kohën e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë për kohën e vuajtjes së dënimit me internim si dënim penal plotësues, për kohën e vuajtjes së dënimit si i dëbuar ose i internuar për shkaqe politike, si dhe për rastet e pushkatimit pa gjyq etj. Ky vërtetim do të lëshohet nga Ministria e Rendit Publik, e cila bashkëpunon për këtë me Ministrinë e Drejtësisë.

6. Kur dokumentet mungojnë, koha e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë me internim, si dënim penal plotësues, si dhe fakti i vdekjes së personit në burg pa qenë i dënuar, i pushkatuar pa gjyq e në kushte të tjera që përmenden në shkronjën “e” të nenit 5 dhe të nenit 7 të ligjit të mësipërm, vërtetohet me komision. Rregullat për krijimin dhe funksionimin e komisionit caktohen nga Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

Për rastet kur dokumentet mungojnë, koha e vuajtjes së dënimit administrativ me internim e dëbim për shkaqe politike, do të vërtetohet sipas rregullave të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445, datë 13.12.1991 “Për vërtetimin e kohës së vuajtjes së dënimit administrativ nga ish-të internuarit dhe të dëbuarit për çështje politike, kur mungojnë dokumentet zyrtare”.

7. Nëse personi është dënuar dhe ka vuajtur dënimin për vepra penale, për të cilat quhet i pafajshëm sipas nenit 1 të ligjit, ashtu edhe për vepra penale që nuk quhet i pafajshëm, Ministria e Rendit Publik, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të përcaktojnë rregullat e llogaritjes së kohës së vuajtjes së dënimit, që do të njihet si vjetërsi pune ose shërbimi. Edhe për këto raste, vërtetimi për kohën që njihet vjetërsi pune ose vjetërsi shërbimi, lëshohet nga Ministria e Rendit Publik.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Vilson Ahmeti

UDHËZIM
Nr.7, datë 29.10.1992

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.2, DATË 4.1.1992

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave e të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 4.1.1992 “Për zbatimin e ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Në pikën 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Personave të dënuar me heqje të lirisë, me internim ose dëbim për motive politike, u jepet pension mesatar, kur nuk kanë mundësi ose nuk kanë interes të zgjedhin pagën mesatare.”.

2. Në pikën 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Koha e vuajtjes së dënimit për të internuarit dhe të dëbuarit njihet si vjetërsi pune për efekt pensioni sipas kategorisë që ka puna e kryer para fillimit të dënimit, pavarësisht nëse ka punuar ose jo gjatë vuajtjes së dënimit, kur ajo (puna e kryer) nuk ka qenë e ndonjë kategorie më të lartë.”.

3. Në pikën 7 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Komisioni i krijuar nga Ministria e Rendit dhe Ministria e Drejtësisë, duke u mbështetur në vendimet gjyqësore, lëshon vërtetime për veprën penale konkrete, në bazë të së cilës është dhënë vendimi. Ky vërtetim shërben si dokument zyrtar për organet e sigurimeve shoqërore.”.

4. Pas pikës 7 shtohen pika 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:

8. “Personat që përfitojnë nga nenet 1 dhe 6 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991, në bazë të kërkesës së tyre, u jepet përkatësisht pensioni që u takon nga koha e lindjes të së drejtës (edhe mbi 3 vjet), si dhe diferenca ndërmjet pensionit që u takon dhe pensionit minimal që u është dhënë.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen organet e Institutit të Sigurime Shoqërore.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

UDHËZIM
Nr.2, datë 6.3.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 4.1.1992 “PËR ZBATIMIN E
LIGJIT NR.7514, DATË 30.9.1991 “PËR PAFAJËSINË, ANMISTINË DHE
REHABILITIMIN E ISH-TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”
NDRYSHUAR ME UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.7, DATË 29.10.1992

Në zbatimin e ligjit nr.7660, datë 14.1.1993 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7514, datë 30.9.1991” dhe me propozimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 4.1.1992 dhe në udhëzimin nr.7, datë 29.10.1992, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 7 ndryshohet si vijon:

“Fakti nëse vepra penale, për të cilën është dënuar personi, quhet krim politik në kuptim të nenit 1 të ligjit nr.7660, datë 14.1.1993, përcaktohet nga komisioni i krijuar nga Ministria e Rendit Publik dhe Ministria Drejtësisë, me përjashtim të rasteve kur dëshmia e penalitetit e përcakton se dënimi është dhënë për veprat penale që parashikohen në nenin 1 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991. Ky komision vërteton edhe faktin e dorëzimit të shqiptarëve gjykatave jugosllave për të njëjtat motive. Ky vërtetim shërben si dokument zyrtar për përfitimin e të drejtave që rrjedhin nga ky ligj.”.

2. Në pikën 6, pas fjalëve “dhe në nenin 7 të ligjit të mësipërm” shtohen fjalët “dhe të nenit 1 të ligjit nr.7660, datë 14.1.1993”.

3. Pika 8 ndryshohet si vijon:

“Personat që përfitojnë nga nenet 1 dhe 6 të ligjit, me kërkesën e tyre ose të familjarëve, u jepet përkatësisht pensioni që u takon nga koha e lindjes të së drejtës (edhe kur kanë plotësuar kushtet duke vuajtur dënimin), si dhe diferenca e pensionit ndërmjet pensionit që kanë marrë dhe atij që u takon në bazë të dispozitave që kanë qenë në fuqi më 30.9.1992.

Duke filluar nga data 20 mars 1993, shumat e pensioneve për periudha të kaluara dhe diferenca e pensionit do të paguhen me këste, si më poshtë:

- a) Deri në shumën 50 mijë lekë, paguhen menjëherë;
- b) Shumat deri në 100 mijë lekë paguhen 50 mijë lekë menjëherë dhe diferenat në tremujorin e dytë të vitit pasardhës;
- c) Shumat deri 150 mijë lekë paguhen: 50 mijë lekë menjëherë, 50 mijë lekë në tremujorin e dytë të vitit pasardhës dhe diferenca në tremujorin e dytë të vitit tjetër;
- ç) Shuma deri në 250 mijë lekë paguhen: 50 mijë lekë menjëherë, 50 mijë lekë në tremujorin e dytë të vitit pasardhës, 50 mijë në tremujorin e dytë të vitit të dytë pasardhës dhe diferenca në tremujorin e dytë të vitit tjetër;
- d) Shumat mbi 250 mijë lekë paguhen në tremujorin e dytë pas një viti të likuidimit të kështit të katërt.”.

4. Në pikën 3 të udhëzimit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Anëtarët e familjes së personave që përmenden në shkronjën “e” të nenit 5 të ligjit përfitojnë pensionin familjar nga koha e lindjes të së drejtës, edhe pse sot mund të jenë madhorë, ose nuk jetojnë më.”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“Përfitimet që lindin në fushën e sigurimeve shoqërore në bazë të ligjit për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, nuk jepen për periudhën para 1.1.1945.”.

6. Pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“Koha e internimit dhe e dëbimit për motive politike nuk njihet vjetërsi pune para moshës 15 vjeç.”.

7. Pas pikës 10 të shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“Personi që është dënuar dhe ka vuajtur dënimin duke qenë pensionist, ka të drejtë të përfitojë pension mesatar sipas këtij udhëzimi.”.

8. Pas pikës 11 të shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

“Në kuptim të pikës 3 të nenit 3 të ligjit, quhen familjarë të ish-të burgosurve politikë fëmijët, gruaja, burri dhe prindërit e tij.”.

9. Personat që marrin pension invaliditeti dhe që përfitojnë nga ky ligj, kanë të drejtën e pensionit mesatar për gjithë periudhën e kaluar.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi, në planin e shpenzimeve për vitin 1993, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen 100 milionë lekë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Mexsi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 22.9.2010
Doli nga shtypi më 22.9.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 20 lekë